



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorëzuar Prijeno / Predato Received / Delivery	05 - 06	2023	3	viti god year
Organ / Njësia Org. / Jednica Org. / Unit	Nr. Prot Br. Prot Prot. No.	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity	
SKPMŠHCK	4596	/2023	1.15	



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.636/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi-kryetare, Arben Mehmeti dhe Malsore Gashi-Bajraktari-anëtarë, me Ardita Perçuku-Shyti-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.636/2023 të datës 14.04.2023 të parashtruar nga ankuesi

kundër Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik/Ministria e Punëve të Brendshme, në çështjen juridike "kërkesë nga marrëdhënia e punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.3 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 05.06.2023, njëzëri mori këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet si e bazuar ankesa A.nr.636/2023 e datës 14.04.2023, e parashtruar nga ankuesi
- II. Anullohet Vendimi Nr.431/2023 i datës 21.03.2023 i Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme, ndërsa mbetet në fuqi Vendimi Nr.1706/2022 i datës 08.11.2022 i Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme, lidhur me emërimin e ankuesit në pozitën Drejtor i Departamentit për Performancë dhe Transparencë Komunale në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal.
- III. Obligohet Njësia e Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, që brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, ankuesit ti lëshoj Akt emërimin për pozitën e punës sipas Vendimit Nr.1706/2022 të datës 08.11.2022 të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë.
- IV. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë të Administrimit të Pushtetit Lokal që të ndërmarr të gjitha veprimet e nevojshme ligjore për zbatimin e këtij vendimi, duke bërë kompensimin e pagave të pa realizuara për ankuesin, sipas sqarimeve në arsyetimin e këtij vendimi.

V. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesi me datë 14.04.2023 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, kundër Vendimit Nr.431/2023 të datës 21.03.2023 të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme, lidhur me shfuqizimin e Vendimit Nr.1706/2022 të datës 08.11.2022 mbi emërimin e ankuesit në pozitën e Drejtorit të Departamentit për Performancë dhe Transparencë Komunale në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, me pretendimet ankimore se vendimi në fjalë përmban shkelje ligjore dhe materiale.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave, me datë 27.04.2023 ankesën e ankuesit e ka proceduar për përgjigje në ankesë në Ministrinë e Punëve të Brendshme, ndërsa kjo e fundit me datën 16.05.2023 ka përcjell përgjigjen në ankesë së bashku me provat materiale lidhur me këtë çështje.

Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil bazuar në dispozitat e nenit 17 paragrafi 2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me Vendimin me numër protokolli 4414/2023 të datës 25.05.2023 ka vazhduar afatin për vendimmarrje lidhur me ankesën e ankuesit edhe për dhjetë (10) ditë pune.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokolli 3548/2023 të datës 14.04.2023 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me numër A.nr.1299/2022 të datës 24.02.2023 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Autorizimin e datës 26.08.2022 të përfaqësuesit të ankuesit; Vendimin me Nr.431/2023 të datës 21.03.2023 të Drejtorit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publike në Ministrinë e Punëve të Brendshme; Vendimin me Nr.111-229/1 të datës 23.03.2023 të Zëvendësuesit të Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal; Vërtetimin e datës 28.12.2018 të lëshuar nga Udhëheqësja e DBNJ/MAPL; Autorizim për avokatin H.S. të datës 26.08.2022; Komunikimin elektronik të datës 22.03.2023, 21.03.2023 ndërmjet ankuesit dhe Drejtorit të DMZP dhe Udhëheqëses së DBNJ të MAPL-së; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 27.02.2023 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigjen në ankesë të datës 16.05.2023 nga Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë-Ministria e Punëve të Brendshme së bashku me provat e bashkangjitura të lëndës; Komunikimin elektronik të datës 15.05.2023, 03.04.2023, 23.03.2023, 21.12.2022, 19.12.2022, 25.11.2022, 25.11.2022, 22.11.2022, 22.11.2022, 11.11.2022, 13.12.2022, 01.12.2022, 15.11.2022, 09.11.2022 ndërmjet zyrtarëve të DMZP-së, MAPL-së, KPMSHCK-së dhe ankuesit; Kërkesën për aprovim sipas vendimit të KPMSHCK-së me Nr.1864 të datës 15.11.2022 nga Zv.Drejtoresha e DMZP-së; Kërkesën me Nr.1963 të datës 05.12.2022 nga Drejtoresha për buxhet dhe financa në MPB/ZKF lidhur me ekzekutimin e pagave sipas vendimit të KPMSHCK-së A.nr.741/2022; Vendimin me Nr.431/2023 të datës 21.03.2023 nga Drejtori i Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë lidhur me shfuqizimin e vendimit për emërimin e ankuesit; Vendimin me Nr.1706/2022 të datës 08.11.2022 lidhur me emërimin e ankuesit në kategori të mesme

drejtuese; Kërkesën për prova shtesë përmes e-mailit zyrtar të datës 24.05.2023 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës për Drejtorin e Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë/MPB; Vendimin VK/2023 të datës 25.05.2023 për vazhdimin e afatit të ankesës së ankuesit në Këshill; Shkresën zyrtare përmes e-mailit zyrtar të datës 01.06.2023 nga Menaxherja e Personelit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal së bashku me urdhër obligimin për pagesë të pagave për ankuesin për datat 03.05.2023, 15.05.2023 si dhe Shkresën zyrtare përmes e-mailit zyrtar të datës 02.06.2023 nga Udhëheqësja e Burimeve Njerëzore në DMZP për Këshillin.

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, konstatoi së janë të bazuara pretendimet ankimore të ankuesit, *sepse*:

Nga administrimi i provave materiale rrjedhë se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me Vendimin A.nr.1299/2022 të datës 24.02.2023, ka aprovuar ankesën e ankuesit Drin Haraqia të datës 08.12.2022, duke obliguar Njësinë e Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal që ankuesit t'i lëshoj Akt emërimin sipas Vendimit me Nr.1706/2022 të datës 08.11.2022 të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme, si dhe është obliguar ky i fundit që të bëjë kompensimin e pagave për ankuesin nga data 06.08.2022 e deri në nxjerrjen e Vendimit Nr.1706/2022 të datës 08.11.2022 të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë (tutje DMZP-ja) dhe njëkohësisht ka obliguar Sekretarin e Përgjithshëm të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, që të bëjë kompensimin e pagave për ankuesin nga data 08.11.2022 deri në zbatimin e vendimit të nxjerrë nga Këshilli.

Tutje, nga shkresat e lëndës del se pas vendimmarrjes së Këshillit sipas Vendimit A.nr.1299/2022, Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë me datë 21.03.2023 ka nxjerrë Vendimin me Nr.431/2023, me të cilin ka shfuqizuar Vendimin Nr.1706/2022 të datës 08.11.2022 për emërimin e ankuesit në pozitën Drejtor i Departamentit për Performancë dhe Transparencë Komunale në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL), me arsyetimin se: *... MAPL pas pranimit të vendimit Nr.1706/2022 të datës 08.11.2022 për emërimin e ankuesit, ka kërkuar rishqyrtim të vendimit duke njoftuar po ashtu për kundërshtimin që është bërë menjëherë pas emërimit nga ana e ish zëvendësueses së Sekretares së Përgjithshme të MAPL-së e në adresë të DMZP-së si dhe se arsyetimi i kërkesës për rishqyrtim është bazuar në nevojën e institucionit që të riorganizoj strukturën e pozitave në kuadër të hartimit dhe miratimit të Rregullores për organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në MAPL...*

Ankuesi në ankesën e parashtruar kundër Vendimit Nr.431/2023 të datës 21.03.2023 të DMZP-së, pretendon së i njëjti është nxjerrë më shkelje ligjore dhe materiale duke kërkuar ky vendim të anulohet, të mbetet në fuqi Vendimi Nr.1706/2022 i datës 08.11.2022, ankuesit ti lëshohet akt emërimi për pozitën e Drejtorit të Departamentit për Performancë dhe Transparencë Komunale në MAPL, dhe së ankuesit ti behët kompensimi i pagës nga data 08.11.2022 deri në zbatimin e këtij vendimi.

Në kuptim të shqyrtimit të pretendimeve ankimore, Kolegji ka analizuar provat materiale të çështjes si dhe vendimin e goditur me ankesë, nga dhe ka konstatuar së lidhur me çështjen e njëjtë Këshilli me Vendimin A.nr.1299/2022 të datës 24.02.2023 kishte vlerësuar se Vendimi Nr.1706/2022 i datës 08.11.2022 për emërimin e ankuesit në pozitën se Drejtorit të



Departamentit për Performancë dhe Transparencë Komunale në MAPL është nxjerrë në pajtim me kompetencat dhe autorizimet ligjore të përcaktuara me nenin 42 paragrafin 7 te Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtaret Publikë si dhe nenin 15 të Rregullores(QRK) Nr.01/2022 për Pranimin, Vlerësimin dhe Disiplinën e Nëpunësve të Lartë Drejtues.


Ndërlidhur me konstatimin si me sipër, e në kuptim të bazushmërisë së Vendimit të kundërshtuar me ankesë përkatësisht Vendimit Nr.431/2023 të datës 21.03.2023 të DMZP-së, Kolegji i Këshillit konstaton se i njëjti dhe arsyet mbi të cilat është nxjerrë ky vendim nuk kanë mbështetje ligjore, sepse nga analizimi i shkresave të lëndës nuk vërtetohet fakti se Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal ka të miratuar Rregullore të re për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës e sipas të cilës pozita e ankuesit sipas Vendimit Nr.1706/2022 të datës 08.11.2022 është shuar ashtu siç është pretenduar në vendimin e kundërshtuar me ankesë, rrjedhimisht, Kolegji konstaton se MAPL-ja ka në fuqi Rregulloren Nr.04/2019 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, sipas së cilës me nenin 14 paragrafin 2 është paraparë pozita e Drejtorit të Departamentit për Performancë dhe Transparencë Komunale.

Po ashtu, nga shkresat e lëndës nuk vërtetohet fakti që pas anulimit të Vendimit Nr.431/2023 të datës 21.03.2023, Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë të ketë ndërmarr ndonjë veprim për sistemin e ankuesit duke marr parasysh përgatitjen arsimore dhe profesionale të tij, andaj mbi bazën e këtyre rrethanave rezulton së është i bazuar pretendimi ankimor në këtë kuptim dhe rrjedhimisht obligohet Njësia e Burimeve Njerëzore të MAPL-së që brenda afatit si në pikën III të dispozitivit ankuesit ti lëshoj Aktin e Emërimit për pozitën e punës Drejtor i Departamentit për Performancë dhe Transparencë Komunale.

Duke u bazuar në nenin 21 paragrafi 1, 2 dhe 3 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji thekson faktin se Vendimet e Këshillit janë vendime administrative të formës së prerë dhe zbatohen nga zyrtaret e nivelit të lartë drejtues ose personat përgjegjës të institucionit që kanë marrë vendimet e para ndaj palës. Zbatimi i vendimit të Këshillit duhet të bëhet brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të vendimit, dhe se moszbatimi i vendimit të Këshillit nga personi përgjegjës i institucionit, paraqet shkelje të rëndë të detyrave të punë.

Për me tepër, Gjykata Kushtetuese me Aktgjykimin KO171/18 të datës 20 maj 2019, paragrafi 163 - 186, ka përcaktuar mjaft qartë se Këshilli i Pavarur gëzon prerogativat e një gjykate në kuptim të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës dhe nenit 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-se. Përmes kësaj praktike gjyqësore, Gjykata ka theksuar se "gjykata" kategorizohet në kuptimin substancial të termit nga funksioni i saj gjyqësor, që do të thotë vendosja e çështjeve brenda kompetencave të saj në bazë të rregullave të së drejtës dhe pas procedurave të kryera në mënyrë të paraparë [...], duke përcaktuar se vendimet e Këshillit të Pavarur janë "**përfundimtare, të detyrueshme dhe të ekzekutueshme**" dhe se Këshilli i Pavarur plotëson kriteret e një "**tribunali**" sipas nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-se, pasi, mes tjerash,(a) është i pavarur prej ekzekutivit; dhe (b) ka juridiksion të plotë për të vendosur për çështjet që vendosen para tij ashtu siç kërkohet me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së.

Andaj, referuar bazës ligjore të më sipërme, rrjedh se organet e administratës publike janë të obliguara që të zbatojnë në plotni vendimet e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, rrjedhimisht nisur nga ky konstatim rezulton se MAPL-ja me rastin e pranimit




të Vendimit A.nr.1299/2022 të datës 24.02.2023 ka qenë e obliguar që ankuesin ta sistemoj në pozitën e punës sipas Vendimit 1706/2022 të datës 08.11.2022 të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë dhe të njëjtit 'i lëshoj Akt Emërimin lidhur me pozitën Drejtor i Departamentit për Performancë dhe Transparencë Komunale.

Lidhur me pretendimin ankimor për kompensimin e pagave sipas pretendimeve në ankesë gjegjësisht për periudhën nga data 08.11.2022 e tutje, Kolegji i Këshillit gjatë procedurës administrative të iniciuar sipas ankesës A.nr.636/2023 të datës 14.04.2023 ka pranuar nga organi i punësimit në këtë rast MAPL-ja dëshmi mbi pagesat e bëra për ankuesin dhe atë Urdhrin e obligimit 2023-93944 të datës 04.05.2023 për pagesë të pagave në vlerën prej 3055.96 euro, Urdhrin e obligimit 2023-103689 të datës 15.05.2023 në vlerën prej 172.22 për pagesë të Trustit Pensional, Urdhrin e obligimit 2023-103675 të datës 15.05.2023 për pagesë të Trustit Pensional në vlerën prej 172.22 euro si dhe Urdhrin e obligimit 2023-103699 të datës 15.05.2023 për pagesë të tatimit në paga në vlerën prej 216.22 euro, andaj, duke qenë se ankuesit pas parashtrimit të ankesës më datë 14.04.2023 i janë bërë pagesat si me lartë, atëherë te njëjtit i njihet e drejta e kompensimit për pjesën tjetër të pa realizuar, deri në datën e zbatimit të këtij vendimi.

Kolegji pas vërtetimit të gjendjes faktike dhe bazës juridike si me lartë, e në mbështetje të të nenit 18 paragrafi 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: *Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi*

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.636/2023.

Ardita Perçulcu-Shyti

Procesmbajtëse

Ardita Haxhnikaj-Demi

Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Përfaqësuesit të ankuesit
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë të Administrimit të Pushtetit Lokal;
- Divizionit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal
- Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik/MPB dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së